

ZHAN-MARI MYLER

Guximi nuk është ta shpërnjohësh frikën, po ta sundosh

Kur lideri luan një rol tepër të madh, ka rrezik ta konfiskojë pushtetin e marrjes së vendimeve brenda lëvizjes. Kjo do ta dëmtonte rëndë demokracinë që do të duhej të mbisundonte në gjë të saj

FRIKE

Veprimi i padhunshëm shpesh kërkon të zbritet në rrugë për të manifestuar në mënyrë publike vullnetin për të luftuar të papraueshmen. Në atë rast përmban rrezikun e konfrontimit të pandërmjetmë, fizik, me ata që poashtu janë në rrugë. Për të vepruar duhet të balancohet me tjetrin, të tjerët, të gjithë të tjerët. Dhe ky ballafaqim fut frikë.

Kemi frikë të dalim për të kryer një veprim publik që na bën të biem në sy dhe na ekspozon ndaj kërcënimeve të të tjerëve. Kështu frikat na mbajnë në rehatinë e jetës private.

Ideologjia dominante do të donte të na impononte heshtjen e frikave tona: ato do të ishin fajtorë dhe prandaj të poshtra. Megjithatë, do të ishte e kotë të pretendosh t'i shtysh, është më mirë të bëhesh i vetëdijshëm për to dhe t'i pohosh, të provosh t'i sundosh pa i mohuar. E turpshme nuk është të kesh frikë, sepse frika është njerëzore, po të lejosh të jeshë i pushtuar nga frika. Guximi nuk është ta shpërnjohësh frikën, po ta sundosh. Dhe është pikërisht frika ajo që lejon guximin. Njeri pa vërejtje nuk është ai që mëton të jetë pa frikë, po ai që e përsundon (tejkalon) frikën e vet.

Frika është këshilltar i keq: para padrejtësisë ajo këshillon pasivitetin dhe para konfliktit shpesh këshillon ikin dhe ndonjëherë dhunën. Nuk duhet të lejojim të na këshillojë frikat: ne duhet të këshillojmë frikat tona.

Frikat tona rrallë janë në proporcion me rrezikun e realitetit të cilit i shtrihen. Për një pjesë të madhe rreziqet janë imagjinare, ndërsa kërcënimet më të mëdha fshihen në të panjohurën. Frikat tona shpesh janë iracionale dhe duhet të përpiqemi t'i bëjmë të arsyeshme. Megjithatë, edhe të zbutura, do të ishte iluzore të mendosh se mund t'i zhdukim tërësisht. Frika e pohuar është tashmë e gjysmë tejkaluare, por vetëm për gjysmë. Gjysma tjetër është e pazbrithshme. Duhet të kemi durim të jetojmë me të, sado e pakëndshme të jetë shoqëria e saj.

Por frikat tona nuk janë vetëm të natyrshme. Në shkallë të ndryshme shtetet prodhojnë dhe mbajnë frika të shumta midis qytetarëve me qëllim që të nxjerrin nga ta shtrimin dhe bindjen për të cilat kanë nevojë. Më së shpeshti ato nuk kanë nevojë të bëjnë terror për t'u shtënë frikën qytetarëve. U mjaftojnë të ushtrorin në mënyrë diskrete një kërcënim difuz për të ushqyer një frikë difuze, e cila do të bëjë të respektohet "ligji dhe rendi". Në shtetet totalitare rendi është vendosur vetëm pasi të jetë vendosur frika. Qytetarët e interiorizojnë një frikë; që të guxosh ta sfidosh shtetin duhej u angazhuar në veprime disidente dhe padëgjueshmërie, duhet ta përsundosh frikën.

Shteti gjithashtu mund të manipulojë frikën e qytetarëve duke theksuar kërcënimin e armikut që tri pezull mbi liritë e tyre. Edhe në këtë rast, shteti mund të kërkojë aq më shumë bindjen brenda shoqërisë, sa më mirë të ketë ditur t'i bindë subjektet se një kërcënim i jashtëm për vdekje pezullon mbi ta. Veprimi i padhunshëm kërkon që t'i tejkalojmë frikën që na paralajzohet. Për t'i tejkaluar është e nevojshme që më parë t'i themi, t'ia themi vetes dhe të tjerëve, dhe të jemi poashtu në gjendje t'i kuptojmë frikën e të tjerëve. Kështu duan krijuar mesazh ku do të mundeshim bashkarisht t'i shprehim frikat tona. Kështu do të mund t'i tejkalojmë mirë bashkë. Por, në pikë të fundit, vetëm duke vepruar bashkarisht mund të jemi të sigurt t'i kemi tejkaluar.

DIALOG

Strategjia e aksionit të padhunshëm përpiqet ta verë në veprim të forcën e fjalës. Në fillim puna është të shtrihen të gjitha mundësitë e dialogut me tjetrin, dmi, e bërë thirrje ndërgjegjese së tij për të provuar të kthehet dhe duke i bërë thirrje arsyes së tij për të provuar ta bindim. Më së shpeshti, forca e fjalës del e pamjaftueshme për të përkulur të fuqishmit, të cilët do të mbrojnë privilegjet ndaj dhe kundër çdokujt.

Ajo që karakterizon një situatë padrejtësie është pikërisht fakti se dialogu midis shtypësit dhe të shtypurve nuk është i mundshëm. Prandaj dialogu nuk mund të jetë mjet për të zgjidhur konfliktin; lufta është i vetmi mjet për të zgjidhur dialogun, dmth, për ta bërë të mundshëm. Funkzioni i luftës së padhunshme në atë rast është të krijojë kushte për dialog, duke vendosur raport të ri forcash, i cili e detyron tjetrin të më njohë si bashkëbisedues të domosdoshëm. Pastaj mund të hapen negociata, të cilat duhet të bëjnë të mundshme të arrihet pajtim që do të vendoste drejtësi.

REZISTENCË PASIVE

Ende shpesh përdoret shprehja "rezistencë pasive" për të shënuar rezistencën e padhunshme. Qysh më 1919, Gandi pohonte: "Termi 'rezistencë pasive' është gabim". Vetë koncepti i "rezistencës pasive" në fakt përmban një kundërtënie të brendshme që i heq çdo

lloj relevance. Rezistenca nuk mund të jetë pasive: pasiviteti karakterizohet pikërisht me faktin se nuk ofron asfarë rezistence ndaj diçkaje.

Shprehja 'rezistencë pasive' mban vullën e ideologjive dominante sipas të cilave nuk mund të ketë aksion pos me dhunë; prandaj, refuzimi i dhunës mund të shprehë vetëm pasivitetin. Kështu jodhuna ka qenë diskredituar për një kohë të gjatë me pretekstin se ajo mundet vetëm të luajë lojën e shtypësve duke çarmatosur të shtypurit dhe duke i dënuar me mosveprim.

JODHUNË

Jodhuna është 'ide e re në Evropë'. Si e tillë shpesh perceptohet përmes keqkuptimeve dhe përzirjeve të shumta që ia ndryshojnë domethënien e vërtetë. Kur dëgjojmë të flitet për jodhunë, reaguim ynë i parë të shpeshtë është mosbesimi dhe skepticizmi. Ky reagim shpjegohet se kemi trashëguar tradita që i kanë dhënë vend me rëndësi dhunës, ndërsa nuk kishte vend për jodhunën.

Fjala jodhunë na vjen nga Gandi. Është përkthim i fjalëpërfjalshëm i fjalës sanskrite Ahimsa (a- private dhe himsa - dhunë). Shpesh është thënë se kjo fjalë ishte zgjedhur keq dhe se në vetë përmbante dy të shumta. (Gandi parapëlqente të përdorte fjalën "satya-graha" (nga satya=e vërtetë dhe graha=dashuri) që e kishte krijuar vetë për të shprehur në mënyrë pozitive idelatin e vet. Ai saktëson: "Etimologjikisht fjala do të thotë: me iu përmbajtë së vërtetë, prej nga del Forca e së Vërtetës". Por vetë shprehja i tillë është gjersisht e dyshshme. E vërteta mund të ketë vetëm forcë të bindjes; ndërkaq, në veprimin politik, kur duhet të luftohet kundër dhunave strukturore të çrregullimit social, nuk mjafton t'i drejtohesh forcës së bindjes. Veprimi i padhunshëm në atë rast duhet të ketë mundësi të verë në veprim një forcë të vërtetë shtrëngimi që do ta detyronte pushtetin e vendosur të

Koncepte të lëvizjes paqësore

Lëvizja për Një Alternativë të Padhunshme (Mouvement pour une Alternative Non-Violente MAN) është një lëvizjet më të rëndësishme paqësore në Francë dhe më gjerë në Evropën e sotme. Në veprimtarinë e saj ka pasur edhe aksione praktike me rëndësi në jetën shoqërore, por ka sidomos refleksione të thelluara dhe intensive për vetë lëvizjen paqësore.

Zhan-Mari Myler (Jean-Marie Muller) është një nga themeluesit e Lëvizjes për një Alternativë të Padhunshme, që zhvillon veprimtari të gjerë konkrete, por merret edhe me probleme të reflektimit teorik të jo-dhunës dhe të veprimeve të mbështetura në të në rrugën për të vendosur drejtësinë. Deri tash ka botuar shumë artikuj e studime, nga të cilat shquhen: "Strategjia e veprimit të padhunshëm", 1981; "Kenë thënë: 'Pacifizëm'?", 1984; bashkë me Zh. Semëlen, "Zhbindja civile", 1985, etj. Tani është bartës humltimesh në Institutin për Kërkime mbi Zgjidhjen e Padhunshme të Konfliktëve (IRNC), i cili boton dhe revistën Alternatives Non Violentes. Numri 68 i kësaj reviste i t'ri është kushtuar Fjalorit të jo-dhunës (Lexique de la non-violence) të hartuar nga Zhan-Mari Myler, që përmban 68 artikuj. Në botimet e Mylerit hetohet përpjekja për ta mbështetur konceptin e veprimit pa dhunë në rrjedhat mendimore, ku vend të veçantë zënë autoritete si E. Veil, P. Riker, H. Markuze, por edhe në përvojat dhe refleksionet e mendimit dhe të veprimit paqësor të M. Gandit, të M. L. Kingut, të L. Del Vasto, të 'solidarnostit' dhe të lëvizjes antikomuniste paqësore në Evropën Lindore, të Saharovit, e këto dy tri vitet e fundit në shkrimet e tij, ashtu si dhe të MAN-in në tërësi, vend të dukshëm zë Lëvizja shqiptare e Kosovës.

Jo vetëm për konceptimin e tij të lëvizjes paqësore, të rezistencës civile, të pacifizmit, që refuzon pasivizmin dhe thekson posaçërisht aspektet e veprimit konstruktiv paqësor, po përkthejmë disa artikuj nga ky fjalor.

Rexhep Ismajli

leshojë pe. Kjo forcë e detyrimit nuk mund të përkufizohet si "forcë e së vërtetës". Megjithatë e ka epërsinë se na obligon të shohim ballë për ballë dytë e shumta të dhunës, ndërsa gjithnjë kemi tentuar t'i fshihim për t'u akomoduar me mirë.

Duhet të bëhemi të vetëdijshëm për kushtëzimin e mrekullueshëm që rri mbi ne me shekuj e që na bën të mëndojmë se dhuna është jo vetëm e domosdoshme po edhe legjitime. Edhe më shumë, se është e ndërur. I takoi legjendës apo historisë, heroi që i paraqitet admirimit tonë është më së shpeshti i dhunshëm në njëfarë mënyre. Nëse dhuna ishte vërtetë virtyti i njeriut të fortë që lufton për të bërë të mbisundojë drejtësinë dhe për të mbrojtur lirinë, jodhuna atëherë mund të jetë vetëm dobësi e atij që nuk e ka guximin të jetë i dhunshëm.

Është e mundshme të veqohet domethënia e jodhunës vetëm pasi të jetë saktësuar domethënia e dhunës. Prandaj duhet të veçojmë atë që e kemi pasur zakon ta ngatërojmë, përkatësisht: konfliktin, agresivitetin, luftën, forcën dhe dhunën e pastër. Dhuna është proces i vdekjes, që rrenon rrenjësisht çdo relacion ndaj tjetrit. Zgjimi ndaj jodhunës ndodh përmes vetëdijesimit për dhunën si realitet rrenjësisht i kundërt ndaj kërkesave të arsyes. Është në fakt përvoja jonë e dhunës në botë që na bën të zbulojmë kërkesën e jodhunës që barim të vetë. Vërtet, kjo kërkesë e shpirtit njerë-

zor është në ne para se të ndeshim dhunën dhe ajo na e zbulon jonjerëzinë e kësaj të dytës. Por ne vetëdijesohemi për çmendinë e dhunës duke u ndeshur me të. Duke identifikuar dhunën si mohim të shpirtit njerëzor, gjykimi etik i kundërve një jo të prerë dhe ia mohan çdo legjitimitet. Është ky refuzim që themelon konceptin e jodhunës.

Kështu jodhuna i përket rendit filozofik dhe, për pasojë, rendit politik. Filozofia që pajtohet me dhunën e mohan veten si filozofi. E njëjta gjë vlen edhe për politikën. Falimentimi i ideologjive dominante është pikërisht legjitimiti i dhunës, pajtimi i saj me idealet e kulturës sonë. Që kur të shpallet legjitime, dhuna bëhet e drejtë për njeriun: ai mund të gjëjë pretëkst të kjo e drejtë për t'u drejtuar dhunës sa herë që të vlerësojë se mbrojtja e interesave të tij i urdhëron të bëjë ashtu. Kur ideologjia e legjitimim dhunën, njerëzit i shtrihen rreziqet të vendosen në praktikën e dhunës duke humbur pak nga pak vetëdijen se ajo është në kundërshtim me aspiratat më të thella të njerëzimit. T'i thuhet ju dhunës duke afirmuar kërkesën etike të jodhunës, kjo do të thotë të refuzosh t'ia njohësh legjitimitetin që e kërkon nga ne me qëllim që të bëhet zot i fatit tonë.

Ideologjitë religjioze poashtu kanë sjellë garancitë e tyre për dhunën duke e legjitimuar. Duke bërë kështu ato i kundërvihen vetë kërkesës shpirtërore të njeriut dhe hidhajn kërkesën etike të jodhunës. Duke ua lenë dishepujë mundësinë të mendonin se dhuna mund të vihej në shërbim të çështjes së Zotit, rekligionet historike - dhe krejt posaçërisht tri religionet monoteste, judaizmi, kristianizmi dhe islamizmi, - e kanë predispozuar njeriun më parë për fanatizëm të dhunshëm sesa për urti të jodhunshme.


Për shkak se ekzistenca etike e jodhunës duhet të bëhet një nga themelet e filozofisë politike që frymëzon veprimin tonë në botë, ajo urdhëron të kërkojmë mjetet e një strategjie që na bën të mundur të marrim mbi vete konfliktet

jshme e "kultit të personalitetit".

Kur lideri luan një rol tepër të madh, ka rrezik ta konfiskojë pushtetin e marrjes së vendimeve brenda lëvizjes. Kjo do ta dëmtonte rëndë demokracinë që do të duhej të mbisundonte në gjë të saj. Për më tepër, nëse ndodh që të zhdukët lideri, ka rrezik që e tërë lëvizja të bjerë në huti të ngjashme me atë që i ndodh jetimit të nesërmen e vdekjes së t'et dhe të mos jetë më në gjendje për ta ndjekur qëllimin. Është i madh rreziku nga çorganizimi i ngadalshëm.

Lëvizja e padhunshme ndodhet përballë dy kërkesave kontradiktore që duhet të korrigjojë njëra tjetrën në një lëvizje dialektike: nga një anë, është e dëshirueshme që lideri t'i japë lëvizjes impulsin për të cilin ka nevojë dhe, nga ana tjetër, është poashtu e dëshirueshme që roli i liderit të jetë i kufizuar. Lideri i padhunshëm duhet të përpiqet të jetë vetëm **primus inter pares**: i pari ndër të barabartit.

Për ta arritur këtë ekuilibër, është më rëndësi që pjesa emocionale që lidh lëvizjen me liderin e saj të jetë sa më e reduktuar që të jetë e mundshme dhe pjesa e saj racionale të jetë sa më e gjërë. Por është sidomos e nevojshme që lëvizja të pajiset me një mënyrë funksionimi sa më demokratik të jetë e mundshme, në mënyrë që të gjithë anëtarët e saj të marrin pjesë efek-



R. Slivova: Në pritje

tivisht në marrjen e vendimeve. Vërtet, kushtet e luftës nuk lejojnë që çdo herë të respektohen laqet dhe vonesat që kërkon demokracia. Aksioni mund të imponojë urgjencat e veta. Por kjo është arsye plotësuere që lëvizja të ketë në dispozicion mjete organizative që ia bëjnë të mundshme të përballojë sa më mirë që të jetë e mundshme situatat e tilla. Sepse, në pikë të fundit, është cilësia demokratike e organizimit të lëvizjes që përbën garancinë më të mirë kundër gjithëpushtetshmisë së liderit.

NEGOCIATA

Sapo të jetë hapur një konflikt, është mirë të hyhet sa më shpejt që të jetë e mundshme në lidhje direkte me kundërshtarin. Madje edhe para se të bëhen publike ndryshimet, duhet të provohet t'i propozohet më parë një zgjidhje me negociata sesa të angazhohemi në sprovë force. Fjala është se duhet t'u bëhen të njohura përfaqësuesve të palës kundërshtarë përfundimet në të cilat na ka shpënë analiza e situatës dhe të rivlerësohen rivendikimet tona duke saktësuar objektivin që duam të arrijmë. Mund të ndodhë që në të parë kundërshtari të refuzojë çdo negociatë. Nëse pranon të na takojë, shumë rrallë ngjet që të arrihet pajtimi menjëherë. Bisedat e para do të bëjnë të mundur të testohen qëllimet e bashkëbiseduesve dhe të njihen më mirë argumentet e tyre. Nëse është me rëndësi të evitohet çdo qëndrim që vetëm do ta nxiste më tej panevojshëm konfliktin dhe të theksonte bllokimet ekzistuese, gjë që do të bënte edhe më të vështirë çfarëdo zgjidhje, ka rëndësi poashtu të tregohet qëndrueshmëria dhe vendosmëria me e madhe e mundshme. Në një konflikt social e politik, ku antagonizmi midis dy palëve ka të bëjë me interesa kontradiktore, negociata do të jetë më shumë garuese sesa kooperative. Duhet, pra, të kërkojmë që negociata të zhvillohet mbi bazë kritereve objektive dhe jo në bazë të dënave subjektive si afirmimi i qëllimeve të mira. Në asnjë rast nuk duhet të kënaqemi me premtime. Duhet të rrugë qorre, ato duhet të shtyhen dhe jo të ndërpriten përfundimisht, sepse qëllimi i veprimit direkt është rimarrja e negociatave. Brenda mundësive, mund të jetë e dobishme të mbahen disa kontakte me kundërshtarin gjatë gjithë konfliktit.

Pas dështimit të negociatave të para, bëhet e domosdoshme t'i hyhet sprovimit të forcës. Kjo duhet ta bëjë kundërshtarin të

shtrënguar të pranojë negociatat që i kishte refuzuar më parë. Nëse situata del e bllokuar, negociatat mund të fillojnë në mënyrë tërthortë me ndërmjetësimin e një a më shumë personave të zgjedhur përmes një pajtimi të përbashkët të të dy palëve. Por ky ndërmjetësim mund vetëm të përgatisë negociatat direkte; vetëm ato mund të sjellin zgjidhje të qëndrueshme të konfliktit.

Edhe nëse mund të shpresojmë arsyeshëm se këto negociata do të bëjnë të mundur të arrijmë një marrëveshje, ato janë ende vazhdimi i provës së forcës dhe jo dialog, i cili mund të zhvillohet në besueshmëri të ndërsjelle. Është të rëndësishme, pra, të ruhen pozitat, të mos suspendohet aksioni dhe të mos bëhet as thuhet gjë që do të mund të çmbilozonte militantët dhe opinionin publik. Pastaj do të ishte skajshmërisht e vështirë të rimobilizohen. S'ka gjë më të dëmshme se të "kllithet fitore" tepër herë. Oferta për negociata mund të jetë kurth për militantët me qëllim që të thyhet vendosmëria, e tyre. Është e rëndësishme, pra, të mbetemi skajshmërisht vigjilentë.

Mund të jetë që do të duhet të pranohet njëfarë kompromisi që do t'ia bënte të mundur kundërshtari "ta shpëtojë fytyrën". Por me pretekstin e arrijtes së një kompromisi të tillë nuk duhet të lëshohet pe për asgjë thelbësore. Kompromisi nuk duhet t'i nxjerrë shpinë për shpine viktimat e padrejtësisë dhe ata të cilët janë përgjegjës për të. Ka rëndësi që fitorja të jetë e prukshme dhe e padiskutueshme. Atëherë mund të fillojë festa...

PACIFIZËM

Fjalët "pacifizëm" dhe "pacifist" në gjuhën, në kulturën dhe historinë tonë kanë një konotacion thelbësisht pejorativ. Pacifisti mbahet i njohur si njeri që do e paqen "me çdo kusht", goftë edhe me çminim e drejtësisë. Akuzohet të parapëlqejë çfarëdo paqe ndaj çfarëdo lufte dhe, pra, të jetë i gatshëm më parë t'i shtrihet shtypjes sesa të luftojë për liri. Në emër të ideologjisë dominante, kolektiviteti nacional do të hedhë anatëmen mbi pacifizist duke i akuzuar si tradhtarë dhe të pabesë.

Është e vërtetë se paqja mund të jetë e turpshme dhe që refuzimi i luftës mund të jetë qyqar. Në rëndësishmja nuk është paqja, por drejtësia që e bën të mundur dinjtetin dhe lirinë. Sikur zgjidhja të bëhej vetëm midis paqes në padrejtësi dhe luftës për drejtësi, në fakt, në atë rast, do të ishte më mirë të zgjidhej lufta. "Do të parapëlqejë një mijë herë t'i hyja rrezikut për t'u kthyer dhunës më parë se sa të shihja tek tridhet një racë e tërë", thoshte Gandi.

Teza qendrore e pacifizmit, ashtu si është shprehur në momente të ndryshme të historisë sonë, mund të përmbilidhet kështu: lufta është e keqja absolute sepse të këqija që prodhon ajo janë domosdo më të mëdha se ato që pretendon t'i shërojë. Vërtet, mjetet e luftës, përkatësisht ato të dhunës shkatërruese dhe vrasëse, janë në kundërtënie vetvetiu me qëllimin që pretendon të ndjekë: koekzistenca paqësore e njerëzve dhe e popujve. E vëreleta e intuitës pacifiste është se proklamoni johumanitetin e luftës dhe refuzon çdo ideologji që justifikon, nderon dhe shenjëron luftën. Por gabimi i pacifizmit është se denoncon "tmerret e luftës" pa propozuar mjete realiste për t'u dhënë fund "tmerreve të paqes". Në fakt, lufta nuk meriton vetëm dënim, ajo kërkon alternativë. Lufta është metodë e veprimit dhe qëllimi i saj është i drejtë nëse synon efektivisht të mbrojë ajo të vendosë të drejtat e njeriut. Metoda e luftës është me siguri e urrejtshme, por veprimi nuk mbetet për kaq më pak i domosdoshëm. Nëse dënim i metodës sjell mosveprimin, kjo do të thotë se dikë është një mungesë në qasje. Në të vërtetë pacifizmi del nga një moral i bindjes dhe duket i paafitë të themelojë një moral të përgjegjësishë përballë sfidave të historisë. Kur ka provuar të propozojë mjete të tjera për vendosjen e paqes pos luftës, ato kanë qenë gjersisht iluzore. Ai u drejtohet virtyeteve në kohën kur vetëm forca i kushtëzoi raportet midis njerëzve dhe popujve. Pacifizmi del nga një vizion idealist dhe moralist i historisë.

Ligjërata pacifiste diskreditohet kur lejon të besojmë se armatat dhe armatimet janë shkaqet e luftimeve dhe kur heqjen e tyre e paraqet si kusht të domosdoshëm dhe të mjaftueshëm për paqe. Për të promovuar një politikë çarmatimi është me rëndësi të konceptohen "barasvlera funksionale të luftës" të cilat u ofrojnë kombeve mjete për t'u mbrojtur nga agresionet eventuale. Pikërisht për shkak se perceptohet në një mënyrë negative nga publiku, fjala "pacifizëm" shpesh përdoret nga ligjëratarat dominues për të shënuar lëvizjet e paqes që i kundërvihen këtij a atij aspekti të politikës ushtarake të shteteve (ato për shembull që denoncojnë ingranimin e vrapimit për armatim). Një nga mjetet më të sigurt për të diskredituar një lëvizje, në fakt, është ta diskualifikosh duke e quajtur. Ky emërtim, që më së shpeshti është akuzë, ka të bëjë me lëvizje që zhvillojnë analiza dhe zgjedhjen objektiva që dallojnë thelbësisht nga ata të "pacifizmit".

Përktheu R. ISMAJLI